



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. **1598** Prot.

Vau Dejes me **28.03**.2022

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Lisen, Njesia Administrative Vau Dejës të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e meposhtëm:

“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 1.02 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje(kende lojërash, mjedise sportive, shlodhëse etj) dhe bën pjesë në ngastren nr.39 në ekonominë pyjore Gomsiqe”

(Paraqitur nga Drejtoria e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë 25.04.2022 ora 10.00 në Fshatin Lisen, Njësia Administrative Vau Dejës, duke respektuar masat anti Covid

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjësës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al , facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI KËSHILLIT

Ardian ÇELEPIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

PROJEKT V E N D I M

Nr. 13, datë 23.03.2022

“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjecar sipërfaqen pyjore prej 1.02 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj), dhe bën pjesë në ngastrën nr.39a në ekonomine pyjore Gomsiqe.

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pika nr 2 germa (a) dhe pika 7 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” ,i propozojmë **Këshillit të Bashkisë Vau Dejës**, ku në mbledhjen e datës _____._____2022 të **Këshillit të Bashkisë** të:

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes në total **1.02** ha për qëllime pushime argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj) qe bën pjese në **ngastren nr.39a** në ekonomine pyjore **gomsiqe**, sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.
2. Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjete) vjet.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Konceptoi: **Z. Ujka**

Konceptoi Bazën Ligjore **K. Shtatri**

Miratoi: **Rr. Ftoni**

KRYETARI
MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 22 prot.

Vau Dejës, më 22.01.2022

RELACION

Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në piken 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet “, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika el neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” pika 7.

Sipërfaqja e marre ne studim do te dale ne ankand nepermjet procedures se prokurimit publik sipas legjislacionit ne fuqi.

Sipërfaqja që planifikohet të jepet në përdorim është 1.02 ha.

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-venë nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” lidhja 2 pika 5/3, **si me poshtë.**

5. Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.)					
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit			
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet	
1	Pyll trungishte	180 000	120 750	100 000	
2	Pyll cungishte	126 000	90 000	75 000	
3	Pyll shkurre	126 000	90 000	75 000	
4	Kullota	126 000	90 000	75 000	
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	90 000	52 000	45 000	
6	Inproduktive	90 000	52 000	45 000	

Vlera totale e pagesës/vit është 76 500 (Shtatedhjetë e gjashtë mijë e pesëqind)lekë

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes prej 1.02ha .

Bashkëlidhur po ju dergojmë.

1.Dokumentacionin e plote dhe harten e ekonomise.

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Ing.Mark Suli



**Specialistet
Ing.Esmeraldo Harapi**




Miratoi

Drejtori

Rrok Ftoni



Ing.Zeqir Ujka



RAPORT

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE NGA
FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU
DEJËS**

**“PËR QËLLIME PUSHIMI, ARGËTIMI, SHENDETSORE, SHOQERORE DHE PËR
VËPRIMTARI TURISTIKE, KAMPINGJE (KËNDE LOJRASH, MJEDISE
SPORTIVE, SHLODHËSË ETJ)”**

Bazuar në Urdhërin **nr.5, datë 12.01.2022** të Kryetarit të Bashkise për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira “për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)”

Grupi i punës i përbërë nga z. Zeqir Ujka, Pergjegjes i sektorit të pyjeve z. Mark Suli, specialist i menazhimit të pyjeve, z. Esmeraldo Harapi specialist kadastrë nga data **23.02.2022** deri në datën **24.02.2022**, realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes kullosore me objekt dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore **1.02** ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)”

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkive, rezulton që sipërfaqja e kërkuar që merret në përdorim është **1.02** ha për qëllime pushimi argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)” dhe bën pjesë në **ngastren nr.39 a** në ekonominë pyjore **gomsiqe**, sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.

Përshkrimi parcellar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur).*

Ndërrhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin jepen në përdorim për një afat **10 vjet** një sipërfaqe prej **1.02 ha** për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj).

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr. 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Përrregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”. Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika nr 2 germa (a) dhe 7.

Sipërfaqja e marre në studim do të dale në ankand nepermjet procedures se Konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, kryetari Bashkise nxjerr urdherin për pregatitjen e dokumentave të ankandit nepermjet procedurës së kunkurimit publik

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-venë nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” lidhja 2 pika 5/3, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. **Shuma në lekë/vit konsiston në:**

1. Vlerën e përdorimit leke/ha/vit

a) Ngastra nr 39a Shkurre 1.02 ha x 75 000 lekë/ha = **76 500** lekë

Në total 76 500 (Shtatedhjetë e gjashtë mijë e peseqind)lekë

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing.Zeqir Ujka



Ing. Mark Suli



Ing.Esmeraldo Harapi



KRYETARI

MARK BABANI



Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR

(sipas regjistrimit kadastral)

Per qellime shoqerore,pushime ,argetimi,etj

Formulari nr.1

ID. Prones	Ekonomia Pyjore	Parcela	Sip.Tot. ha	Perberja grumbullit	Funksion i	Forma Qeverisjes	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor					Fuqia lendore	
									D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Kat et	Per ha	Total
SH67 00 039a	Gomsiqe	39a	46.67	mare	prodhues	shkurre	35	0.6	6	4	0	0	N	57.7	2600
			46.67				0	0	0	0	0	0	0	57.7	2600

Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR

(sipas verifikimit ne terren)

Per qellime shoqerore,pushime ,argetimi,etj

Formulari 2

ID. Prones	Ekonomia	Parcela	Sip.Tot.	Perberja grumbulli	Funksion	Forma Qeverisjes	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
									D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli dellinje	Kat	Per ha	Total
SH67 00 039a	Gomsiqe	39a	46.67	mare	prodhues	shkurre	35	0.6	6	4	0		N	57.7	2600
			46.67											57.7	2600

PLOTESOI:

Ing.Mark Suli



Ing. Zeqir Ujka



Ing. Esmeraldo harapi



Bashkia Vau Dejës

**LISTA E NGASTRAVE, N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM
Per qellime shoqerore,pushime ,argetimi,etj**

Formulari 5

Nr.	ID Prone	Ekonomia Pyjore/kull osore	Ng/neng,nr.	Siperfaqie qe hiqet nga fondi pyjor/kull osor	Siperfaqja			Gjatesia ne perdorim		Tubacion/ kanal
					Siperfaqie qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kull osor ha	Rruge km	Linje			
1	2	3	4	5	6	7	8			9
1	SH67 00 039a	Shosh 2	39a	0	1.02	0	0			0
Shuma					1.02					

PLOTESOI:

Ing.Mark Suli



Ing. Zeqir Ujka



Ing. Esmeraldo Harrapi



Bashkia Vau Dejës

TABELA PERMBLEDHJESE E VLERESIMIT FINANCIAR
Per qellime shoqerore,pushime ,aragetimi etj.

Formulari nr.4

Perdorimi I territorit	Sip ha	Bashkia	Volumi ne m ³ sipas asortimenteve	Sasia	Vlera Leke /m3	Shuma I	Gjatesia e perdorimit rruge ne km	Tarifa dhenje ne perdorim lek/ha/vit			Shuma II	Totali I+II
								1	2.-5	6.-10		
0	1	2	3		4	5	6	8	9	10	11	12
Pyll	1.02	V.Dejës	0	0	0	0	0	126 000	90 000	75 000	76 500	76 500
Gjuetia	0	V.Dejës	0		0	0	0	0	0	0	0	0
Invest	0	V.Dejës	0		0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsejt	1.02				0	0	0				0	76 500

PLOTESOI:

Ing.Mark Suli




Ing. Zeqir Ujka



Ing. Esmeraldo harapi





[Handwritten signature]